

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8159
E premte, 10 tetor 2025
Çmimi 0.50 €

Kosova mirëpret
marrëveshjen e paqes
në mes të Izraelit
dhe Hamasit I FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DEPUTETËT PAGUHEN MBI NJË MILION EURO PËR "ZERO PUNË"

 I FAQE 5

Në Kosovë, ku paga minimale është 350 euro, deputetët e Kuvendit marrin paga të plota prej muajsh pa zhvilluar asnjë seancë të rregullt. Njëqind e pesë deputetë të paguar,

duke përfshirë 15 anëtarët e qeverisë, i kushtojnë buxhetit mbi 200 mijë euro në muaj vetëm për pagat bazë. Mbi një milion euro kanë përfituar deputetët e Kuvendit të

Kosovës për gati gjysmë viti pa arritur ta konstitujnë Kuvendin dhe pa zhvilluar pothuajse asnjë aktivitet parlamentar, konfirmoi zyra për medie e institucionit ligjvënës

**HASANI: GJYKATA
TREGOI KUSH E BLOKUI
KUVENDIN, POR DUHEJ
TA SANKSIONONTE
SJELLJEN E LV-së** F. 7



**KUVENDI
VAZHDON SEANCËN
KONSTITUIVE
PËR ZGJEDHJEN
E NËNKRYETARIT
NGA KOMUNITETI
SERB** F. 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**IZRAELI DHE HAMASI PAJTOHEN
PËR ARMËPUSHIM NË GAZË DHE
KTHIMIN E PENGJEVE** F. 2

**KQZ-ja: NË 38 KOMUNAT E
KOSOVËS PO PUNOHET PA PUSHIM
PËR DITËN E ZGJEDHJEVE LOKALE** F. 3

**PUNË NGA BEOGRADI PËR
SERBËT NË KOSOVË: NDIHMË
APO MANIPULIM ZGJEDHOR?** F. 6

EKONOMI



**AKB-ja: ATK-JA DUHET
TË JETË PARTNERE EDUKUESE,
JO NDËSHKUESE** F. 8

**BQK-ja DHE ODA EKONOMIKE
DISKUTOJNË PËR ZGJERIMIN E
BASHKËPUNIMIT** F. 8

SPORT



**KOSOVA SYNON FITORE NDAJ
SLLOVENISË** F. 11

IZRAELI DHE HAMASI PAJTOHEN PËR ARMËPUSHIM NË GAZË DHE KTHIMIN E PENGJEVE

JERUSALEM, 9 TETOR - Izraeli dhe Hamasi e kanë arritur një marrëveshje të shumëpritur të mërkurën vonë për armëpushim dhe për lirimin e pengjeve - që është faza e parë e planit të presidentit amerikan Donald Trump për t'i dhënë fund luftës në Gazë, e cila ka vrarë mbi 67 000 njerëz dhe ka ndryshuar Lindjen e Mesme.

Vetëm një ditë pas përvjetorit të dytë të sulmit vdekjeprurës të Hamasit - grupit palestinez të shpallur terrorist nga ShBA dhe vende të tjera, i cili e nxiti luftën shkatërruese në Gazë, bisedimet e tërthorta në Egjipt sollën një marrëveshje për fazën fillestare të planit 20-pikësh të Trumpit për të sjellë paqe në enklavën palestineze.

Nëse zbatohet plotësisht, marrëveshja do t'i afrojë të dyja palët më shumë se çdo përpjekje e mëparshme për t'i dhënë fund një lufte që u shndërrua në një konflikt rajonal, duke përfshirë vende si Irani, Jemeni dhe Libani, duke thelluar izolimin ndërkombëtar të Izraelit dhe duke ndryshuar dinamikën në Lindjen e Mesme.

Lajmi për marrëveshjen nxitë festë në Izrael, Gazë dhe më gjerë. Familjet e pengjeve izraelite hodhën fishekzjarrë, ndërsa palestinezët duartrokitën dhe brohoritën me shpresën se gjakderdhja do të ndalet. "Falënderuar qoftë Zoti për këtë armëpushim, për ndaljen e gjakderdhjes dhe vrasjeve!", tha Abdul Majeed abd Rabbo, banor i qytetit Han Junis në jug të Gazës. "Nuk jam vetëm unë i lumtur, i gjithë Rripi i Gazës është i lumtur, të gjithë njerëzit arabë, gjithë bota është e lumtur për

armëpushimin dhe për fundin e gjakderdhjes", shtoi ai. Por, marrëveshja e shpallur nga Trumpi të mërkurën vonë dha pak hollësi dhe la shumë pyetje të hapura që mund ende të bëjnë që ajo të dështojë, ashtu siç ka ndodhur me përpjekjet e mëparshme për paqe. "Jam shumë krenar të njoftoj se Izraeli dhe Hamasi kanë nënshkruar fazën e parë të Planit tonë të Paqes", tha Trumpi në platformën "Truth Social". "Kjo do të thotë se të gjitha pengjet do të lirohen shumë shpejt dhe Izraeli do t'i tërheqë trupat e tij deri në një shkallë të dakorduar, si hapat e parë drejt një Paqeje të Fortë, të Qëndrueshme dhe të Përhershme", shtoi ai.

Zbatimi i marrëveshjes do të përbënte një arritje të rëndësishme në politikën e jashtme për presidentin republikan, i cili kishte premtuar të sillte paqe në konfliktet kryesore botërore, por ka hasur në vështirësi për t'i realizuar ato shpejt, si në Gazë, ashtu edhe për pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu tha se do ta thërrasë kabinetin e vet qeveritar të enjten për ta miratuar marrëveshjen. "Me miratimin e fazës së parë të planit, të gjitha pengjet tona do të kthehen në shtëpi", tha ai në një deklaratë. "Kjo është një arritje diplomatike dhe një fitore kombëtare e morale për shtetin e Izraelit", shtoi ai.

Hamasi konfirmoi se ka arritur një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës, duke thënë se ajo përfshin tërheqjen izraelite nga enklava dhe një shkëmbim pengjesh me të burgosur. "Ne pohojmë se sakrificat e popullit

tonë nuk do të jenë të kota dhe se do t'i qëndrojmë besnikë zotimit tonë; kurrë nuk do t'i braktisim të drejtat kombëtare të popullit tonë derisa të arrihen liria, pavarësia dhe vetëvendosja", tha Hamasi.

Autoritetet e Gazës thonë se mbi 67 000 njerëz janë vrarë dhe pjesa më e madhe e enklavës është shkatërruar qëkurse Izraeli e filloi ofensivën ushtarake pas sulmit përtej kufirit nga Hamasi më 7 tetor 2023. Sipas zyrtarëve izraelitë, rreth 1 200 njerëz u vranë në Izrael dhe 251 u morën peng e u dërguan në Gazë. Besohet se 20 nga 48 pengjet e mbetura në Gazë janë ende gjallë.

Pavarësisht prej shpresave për t'i dhënë fund luftës, ende nuk janë bërë të ditura hollësitë thelbësore - përfshirë afatet kohore, administrimi i Rripi të Gazës pas luftës dhe fati i Hamasit.

Lirimi i pengjeve pritet të ndodhë brenda disa ditësh

Familjet e izraelitëve që po mbahen peng në Gazë u mbledhën në atë që tashmë njihet si "Sheshi i Pengjeve" në Tel Aviv pas shpalljes së marrëveshjes. "President Trump, faleminderit shumë! Ne e falënderojmë atë. Fëmijët tanë nuk do të ishin kthyer në shtëpi pa të", tha Hatana Angrest, babai i Matanit, njërit nga pengjet.

Një burim brenda Hamasit i tha agjencisë "Reuters" tha se pengjet që janë ende gjallë do të dorëzohen brenda 72 orëve nga miratimi i marrëveshjes nga qeveria izraelite.



Zyrtarët e Hamasit kanë theksuar se do të nevojitet më shumë kohë për t'i tërhequr trupat e pengjeve të vrarë, që besohet të jenë rreth 28, nga rrënojat e Gazës.

Trumpi i tha programit "Hannity" të "Fox News" se pengjet "me shumë gjasë do të lirohen të hënën".

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, bëri thirrje që të gjitha palët t'i respektojnë plotësisht kushtet e marrëveshjes për pengjet. "Duhet të sigurohet hyrja e menjëhershme dhe e papenguar e ndihmave humanitare dhe materialeve tregtare thelbësore në Gazë. Dhimbja duhet të marrë fund", tha ai në një deklaratë.

Faza e ardhshme e planit të Trumpit parashikon krijimin e një organi ndërkombëtar të udhëhequr nga vetë Trumpi dhe me pjesëmarrjen e ish-kryeministrit britanik, Tony Blair, që do të ketë rol në administrimin e Gazës pas luftës. Vendet arabe, që mbështesin planin, thonë se ai duhet të çojë drejt pavarësisë së ardhshme të

një shteti palestinez, diçka që Netanyahu ka deklaruar se "nuk do të ndodhë kurrë". Nuk ka ende asnjë tregues të qartë se kush do ta qeverisë Gazën pas përfundimit të luftës.

Netanyahu, Trumpi, si dhe shtetet perëndimore dhe ato arabe, e kanë përjashtuar mundësinë që Hamasi të ketë ndonjë rol, pasi ky i fundit e ka qeverisur Gazën që nga dëbimi i rivalëve palestinezë në vitin 2007. Hamasi ka deklaruar se do t'ia dorëzonte drejtimin e Gazës vetëm një qeverie teknokrate palestineze, nën mbikëqyrjen e Autoritetit Palestinez dhe me mbështetjen e vendeve arabe dhe myslimane.

Ky grup ka refuzuar çdo rol për Tony Blairin apo çdo formë të administrimit të huaj në Gazë. Zemërimi global kundër ofensivës së Izraelit është rritur ndjeshëm. Shumë ekspertë për të drejtat e njeriut, studiues dhe një hetim i OKB-së, kanë thënë se ajo përbën "gjenocid". Izraeli, nga ana tjetër, e cilëson ofensivën si vetëmbrojtje pas sulmit të Hamasit në vitin 2023.

VON DER LEYEN I MBIJETON VOTËBESIMIT NË PARLAMENTIN EVROPIAN

BRUKSEL, 9 TETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, u ka mbijetuar me lehtësi dy mocioneve të votëbesimit në Parlamentin Evropian të enjten, pasi deputetët kundërshtuan përpjekjet e grupeve të ekstremit të djathtë dhe të majtë për ta shkarkuar atë. Ajo e fitoi votëbesimin e ligjvënësve të BE-së në Parlamentin me 720 ulëse. Von der Leyen e mori mbështetjen e 378 ligjvënësve në votimin e parë, si dhe të 383 të tjerëve në të dytin.

Von der Leyen tha në një postim në X se e vlerëson thellësisht mbështetjen dhe se ekipi i saj i

komisionarëve do të punojë ngushtë me Parlamentin për t'u përballur me sfidat e Evropës. Këto rezultate ishin pak më të mira për shefen e ekzekutivit të BE-së sesa ato në korrik, kur 360 ligjvënës votuan kundër një mocioni të ngritur kryesisht nga deputetë të ekstremit të djathtë, pak më pak se 401 votat që ajo i mori për t'u rizgjedhur për një mandat të dytë në korrik 2024. Edhe pse mocionet e votëbesimit kishin shumë pak gjasa ta arrinin shumicën prej dy të tretash të nevojshme për ta rrëzuar von der Leyenin, disa ligjvënës thanë se ato mund ta nxjerrin në pah pakënaqësinë e



përgjithshme ndaj udhëheqjes së saj dhe ta destabilizojnë Parlamentin e BE-së, mbështetja e të cilit është e nevojshme për miratimin e ligjeve.

Partitë jashtë rrymave kryesore kanë kuptuar se mocionet e votëbesimit - që dikur përdorshin rrallë - janë të lehta për t'u ngritur pas zgjedhjeve të

vitit 2024, të cilat e rritën numrin e deputetëve të ekstremit të djathtë në mbi 100, ndërsa nevojiten vetëm 72 për të mbështetur një mocion të tillë.

Të dy mocionet kritikuan von der Leyenin për pranimin e një marrëveshjeje të pabalancuar tarifash me Shtetet e Bashkuara dhe për propozimin e një marrëveshjeje tregtare me bllokun e Amerikës së Jugut, Mercosur, që kritikët thonë se kërcënon bujqit dhe mjedisin. Marrëveshjet me ShBA-në dhe Mercosurin do t'u nënshtrohen votimeve në Parlamentin Evropian në muajt e ardhshëm.

KQZ-ja: Në 38 komunat e Kosovës po punohet pa pushim për ditën e zgjedhjeve lokale

PRISHTINË, 9 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se në 38 komunat e Kosovës po punohet pa pushim

për Ditën e Zgjedhjeve më 12 tetor dhe procesin që fillon të hënën. Në njoftimin për medie është bërë me dije se KQZ-ja ka

caktuar qendrat komunale të numërimit dhe gjatë kësaj jave komisionet komunale të zgjedhjeve janë në

procesin e përgatitjes së tyre për numërimin e votave të kandidatëve për anëtarë të kuvendeve komunale.



KUVENDI VAZHDON SEANCËN KONSTITUIVE PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARIT NGA KOMUNITETI SERB



PRISHTINË, 9 TETOR - Kuvendi i Kosovës ka bërë me dije në faqen e vet se do ta mbajë vazhdimin e seancës konstituive më 10 tetor në orën 10:00. Ai e ka të përcaktuar vetëm një pikë në rendin e ditës: zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga komuniteti serb. Njoftimi i Kuvendit vjen një ditë pas publikimit të aktgjykimit të plotë të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë proces. Gjykata erdhi në përfundim se zgjedhja e nënkryetarit nga radhët e komunitetit serb është e domosdoshme për përmbylljen e konstituimit të Kuvendit të Kosovës. Sipas saj, votimi në pako për nënkryetarët e Kuvendit nuk është i imponueshëm, por mund të realizohet me pajtim ndërmjet grupeve parlamentare. Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit - ishte ankuar pikërisht për këtë pikë të procedurës, duke pretenduar se mosvotimi në pako i dy nënkryetarëve nga pakicat përbënte shkelje.

Kuvendi i ka zgjedhur kryetarin, tre nënkryetarët shqiptarë dhe nënkryetarin nga pakica joserbe tashmë, por ka dështuar ta zgjedhë atë nga pakica serbe - me gjithë vazhdimet e pafundme të seancës së nisur më 15 prill. Deputetët do të kenë tani 12 ditë kohë, sipas urdhrat të gjykatës më të lartë të vendit, për ta zgjedhur nënkryetarin serb dhe për ta bërë Kuvendin e ri përfundimisht. Gjykata nuk ka sqaruar as në aktgjykimin e fundit se çfarë ndodh tutje nëse nuk zgjidhet nënkryetari serb dhe Kuvendi nuk konstituohet brenda 12 ditëve afat.

Si erdhi situata deri këtu?

Në proces e sipër të konstituimit të Kuvendit, kryetari i porsazgjedhur, Dimal Basha, u kërkoi propozime partive politike për pesë nënkryetarë të Kuvendit. Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje, Vlorë Çitaku nga

Partia Demokratike e Kosovës dhe Kujtim Shala nga Lidhja Demokratike e Kosovës u zgjedhën nënkryetarë të Kuvendit përmes një votimi në pako. Më pas u votua Emilija Rexhepi nga pakica joserbe përmes një votimi të ndarë nga pakica serbe. Kur u kërkua emri i kandidatit për nënkryetar nga pakica serbe, Lista Serbe e propozoi Sllavko Simiqin. Ai nuk i mori votat e domosdoshme, mirëpo subjekti politik nuk hoqi dorë nga emri i tij. Kryetari Basha më pas i shfrytëzoi dy mekanizmat zhblokuës, duke ndjekur procedurën e shortit dhe i hodhi nga tri herë në votim tetë prej 10 pjesëtarëve të komunitetit serb, meqë dy deputetë kishin refuzuar të kandidoheshin. Pavarësisht se asnjëri kandidat nuk i mori votat e nevojshme, Basha erdhi në përfundim se Kuvendi ishte konstituuar dhe se puna duhet të vazhdonte. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se Kuvendi nuk

konsiderohet i konstituuar pa u zgjedhur edhe nënkryetari serb. “Nëse Kuvendi nuk arrin ta zgjedhë nënkryetarin nga radhët e deputetëve të komunitetit serb, Kryesia e saj do të ishte e paplotë dhe jokushtetuese. Në këtë kontekst, zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga komuniteti serb si anëtar i domosdoshëm i Kryesisë së Kuvendit, është parakusht për konstituimin e Kuvendit”. Në një pikë të aktgjykimit, Gjykata ka përmendur se ekzistojnë raste kur Kuvendi do të mund ta vazhdonte punën edhe pa i zgjedhur të gjithë nënkryetarët, mirëpo që ky nuk është as rasti dhe as nuk ka të bëjë me rrethanat konkrete, meqë procesi tani nuk është finalizuar për shkak të mosvotimit të shumicës së deputetëve të zgjedhur të Kuvendit për kandidatët e propozuar, qoftë të propozuar drejtpërdrejt ose përmes shortit. Në aktgjykimin e plotë, Gjykata ka thënë se, bazuar në Kushtetutë dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, nënkryetari i Kuvendit

nga komuniteti serb zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, respektivisht 61 vota për, dhe propozimi bëhet me shkrim nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit serb. “Nga si më sipër, Gjykata nënvizon se propozimi për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastin konkret, të komunitetit serb, duhet të bëhet nga shumica apo numri më i madh i deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit serb”. Në përbërjen e Kuvendit, Lista Serbe i ka nëntë ulëse që janë të rezervuara për komunitetin serb dhe një tjetër e ka fituar Nenad Rashiç nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, i cili është edhe ministër në detyrë në qeverinë e Albin Kurtit. Pavarësisht se kanë kaluar muaj prej mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në shkurt, Kosova vazhdon të mos i ketë institucionet e reja. Partitë më të mëdha shqiptare nuk kanë arritur pajtueshmëri për ta çuar procesin përpara dhe, për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese është detyruar të dalë disa herë me aktgjykime. Lëvizja Vetëvendosje doli e para dhe fitoi 48 ulëse në Kuvend, duke lënë prapa Partinë Demokratike të Kosovës me 24 ulëse, Lidhjen Demokratike të Kosovës me 20, Listën Serbe me nëntë dhe koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate me tetë të tilla. Edhe 11 ulëse të tjera janë të pakicave. Faktori ndërkombëtar ka bërë disa herë thirrje që Kosova t'i formojë sa më shpejt institucionet e reja. Më herët Ambasada e Gjermanisë në Kosovë u ka bërë thirrje deputetëve që t'i respektojnë vendimet e Kushtetueses dhe të mos i kenë në plan të parë interesat partiake.

Policia dhe EULEX-i diskutojnë për sigurinë në vend dhe për procesin zgjedhor

PRISHTINË, 9 TETOR - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, ka pritur të enjten në një takim shefin e misionit të EULEX-it në Kosovë, Giovanni Pietro Barbano. Gjatë këtij takimi u diskutua

rreth gjendjes aktuale të sigurisë në vend dhe për ngritjen e mëtejme të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për ta pasur një ambient sa më të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët pa dallim.

Ndër temat e diskutuara ishte edhe ajo për planifikimin dhe angazhimin policor në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, ku tanimë Policia e Kosovës veçse ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme policore në aspektin e sigurisë.





DEPUTETËT PAGUHEN MBI 1 MILION EURO PËR “ZERO PUNË”

Në Kosovë, ku paga minimale është 350 euro, deputetët e Kuvendit marrin paga të plota prej muajsh pa zhvilluar asnjë seancë të rregullt. Njëqind e pesë deputetë të paguar, duke përjashtuar 15 anëtarët e qeverisë, i kushtojnë buxhetit mbi 200 mijë euro në muaj vetëm për pagat bazë. Mbi një milion euro kanë përfituar deputetët e Kuvendit të Kosovës për gati gjysmë viti pa arritur ta konstituojnë Kuvendin dhe pa zhvilluar pothuajse asnjë aktivitet parlamentar, konfirmoi zyra për medie e institucionit ligjvënës

Në Kosovë, ku paga minimale është 350 euro, deputetët e Kuvendit marrin paga të plota prej muajsh pa zhvilluar asnjë seancë të rregullt. Njëqind e pesë deputetë të paguar, duke përjashtuar 15 anëtarët e qeverisë, i kushtojnë buxhetit mbi 200 mijë euro në muaj vetëm për pagat bazë. Ekspertët thonë se ngërçi politik në Kuvend po frenon zhvillimin ekonomik të vendit dhe po pengon përfitimet nga fondet evropiane. Mbi një milion euro kanë përfituar deputetët e Kuvendit të Kosovës për gati gjysmë viti, pa arritur të konstituojnë Kuvendin dhe pa zhvilluar pothuajse asnjë aktivitet parlamentar, konfirmoi zyra për media e institucionit ligjvënës. Një situatë e paprecedentë që

ngre pyetje serioze mbi përgjegjësinë dhe moralin e përfaqësuesve të qytetarëve. Sipas Ligjit për Pagat në sektorin publik, paga bruto mujore e një deputeti është 1 804 euro, por pas rritjes këtë vit prej 110 eurosh, të miratuar nga Qeveria e Kosovës, paga aktuale është 1 914 euro. Me 105 deputetë të paguar - duke përjashtuar 15 anëtarët e qeverisë që nuk marrin paga si deputetë - buxhetit të shtetit i hiqen mbi 200 mijë euro çdo muaj vetëm për pagat bazë. Nëse kjo shumë llogaritet për periudhën e bllokimit institucional nga 15 prilli deri sot, shpenzimet arrijnë mbi 1 milion euro, pa llogaritur përfitimet e tjera, si shtesat për pjesëmarrje në komisione apo shpenzimet e udhëtimit. Zyrtarët për medie të Kuvendit specifikuan për “Radion Evropa e

Lirë” se shumta e pagave të deputetëve nga 15 prilli deri më 30 shtator ka arritur në 1.156 milion euro. REL-i kontaktoi edhe disa prej deputetëve, të cilët konfirmuan gjithashtu marrjen e pagës. “Kjo është publike, mund të kontaktohet edhe Kuvendin, çdo deputet i merr pagat, pavarësisht se a është duke funksionuar apo jo Kuvendi”, tha Rashit Qalaj, deputet nga Partia Demokratike e Kosovës. “Jemi duke pritur shumë gjatë që Kuvendi të funksionojë, por nuk po i shihet fundi kësaj bllokade”, u shpreh ai. Burbuqe Kastrati nga Lëvizja FOL, organizatë që promovon transparencën dhe

llogaridhënien në institucionet publike, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se kjo situatë është ligjshme e justifikueshme, por moralisht e papranueshme. Sipas saj, marrja e pagës së plotë pa asnjë angazhim praktik tregon nevojën urgjente për rishikimin e ligjit që rregullon përfitimet e deputetëve. “Për shembull, mund të vendosen kufizime për periudhat kur konstituimi dhe puna e Kuvendit zvarriten”, shpjegon Kastrati. Edhe profesori i Ekonomisë, Shkumbin Misini, e konsideron këtë situatë të padrejtë dhe të pandershme. “Ligji duhet ndryshuar menjëherë, në mënyrë që shpërblimi të lidhet me

prezencën, punën dhe rezultatet. Asnjë punë, asnjë pagesë”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”. Misini shton se në një vend të varfër si Kosova, ku paga minimale është 350 euro, nuk është e drejtë që një deputet të paguhet gjashtëfish më shumë dhe aq më tepër për “zero punë”. Kastrati vlerëson se heqja dorë vullnetare nga paga do të ishte një shembull pozitiv për integritetin e Kuvendit. Por deri më sot, sipas saj, asnjë deputet nuk ka bërë një veprim të tillë. Nga Kuvendi i Kosovës konfirmuan gjithashtu - “asnjë deputet nuk ka hequr dorë nga paga, me përjashtim të deputetëve që mbajnë pozita në ekzekutiv”.

Pse Kuvendi nuk funksionon?

Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës nisi më 15 prill, por edhe pas dhjetëra vazhdimëve ajo nuk arriti të përmbyllet për shkak të mosmarrëveshjeve politike. Kryetari dhe katër nënkryetarë u zgjodhën në fund të gushtit, por nënkryetari i pestë nga komuniteti serb, i kërkuar me ligj, mbetet ende pa u emëruar. Çështja përfundoi në Gjykatën Kushtetuese, e cila më 8 tetor publikoi aktgjykimin e datës 30 shtator, me të cilin konstatoi se seanca konstituive e Kuvendit, e nisur më 15 prill, nuk ka përfunduar dhe se ajo duhet të përfundojë brenda 12 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi.

Humbjet ekonomike nga mosveprimi i deputetëve

Ndërsa paga e deputetëve mbetet temë e diskutueshme, ekspertët theksojnë se humbjet më të mëdha për Kosovën nuk janë vetëm financiare. Naim Jakaj, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), thotë për Radion Evropa e Lirë se, edhe pse kostoja mujore për pagat e deputetëve është e lartë, ajo është e papërfillshme krahasuar me dëmet që po i shkakton vendit bllokimi

KOSOVA MIRËPRET MARRËVESHJEN E PAQES NË MES TË IZRAELIT DHE HAMASIT

PRISHTINË, 9 TETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka përshëndetur arritjen e paqes në mes të Izraelit dhe Hamasit. Mbrëmë pas mesnate, presidenti amerikan, Donald Trump njoftoi për nënshkrimin e fazës së parë të planit të paqes në Lindjen e Mesme. E sipas Osmanit, ky është një moment përcaktues për paqen që është vonuar shumë. “Presidenti Donald Trump dhe administrata e tij kanë treguar leadership dhe angazhim të vërtetë për të sjellë paqe të qëndrueshme për izraelitët dhe palestinezët njësoj, edhe përkushtim të palodhur për t’u dhënë fund vuajtjeve që kanë duruar breza të tërë njerëzish të

pafajshëm”, u shpreh Osmani. Edhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka reaguar pas njoftimit për arritjen e marrëveshjes së paqes ndërmjet Izraelit dhe Hamasit, duke e cilësuar atë si një hap të rëndësishëm drejt paqes së qëndrueshme dhe stabilitetit afatgjatë në Lindjen e Mesme. Në një deklaratë zyrtare, MPJD ka vlerësuar lart leadershipin e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, në këtë proces, si dhe ka përgëzuar përpjekjet ndërmjetësuere të Turqisë, Katarit dhe Egjiptit, të cilat kanë qenë thelbësore në arritjen e këtij zhvillimi historik. “Marrëveshja përfaqëson një hap vendimtar në zbatimin e



fazës së parë të nismës për paqe në Gaza të presidentit Trump, duke mundësuar vendosjen e një armëpushimi të plotë,

lirimin e pengjeve dhe zgjerimin e ndihmës humanitare për civilët në nevojë në Gaza”, thuhet në

njoftim. Edhe kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka mirëpritur arritjen e marrëveshjes së fazës së parë në Lindjen e Mesme sipas planit të presidentit Trump. Haradinaj në “Facebook” u shpreh se kjo marrëveshje historike është hapi i parë i normalizimit dhe besimit në një paqe të qëndrueshme dhe afatgjatë. “Kosova rikonfirmon mbështetjen e saj të palëkundur për paqen, sigurinë dhe mbrojtjen e jetës njerëzore, duke shprehur besimin se ky zhvillim do ta hapë rrugën për një stabilitet të qëndrueshëm në rajon në dobi të të gjithë popujve”, ka thënë Haradinaj.

FSK-ja, E ARGJENDTË NË GARËN “CAMBRIAN PATROL” NË MBRETËRINË E BASHKUAR

PRISHTINË, 9 TETOR - Ekipi i FSK-së në kuadër të aktiviteteve bilaterale me Mbretërinë e Bashkuar ishte pjesë në Garën “Cambrian Patrol” të organizuar nga Ushtria Britaneze. Në këtë garë ekipi i FSK-së arriti të dekorohet me medaljen e argjendtë në mesin

e 118 ekipeve, 35 ekipe ndërkombëtare nga 33 shtete të ndryshme të botës. Gara “Cambrian Patrol” është një nga garat më sfiduese në botë dhe ekipet kalojnë nëpër detyra sfiduese ushtarake si përgatitje taktike, përballje me rreziqe CBRN, operacione mjekësore, rikonicion dhe

zbulim të forcave, sulm, eksploziv dhe fushë e minuar, kalim i pengesave ujore, caqe të artilerisë fushore dhe përballje me situata të burgosurve. Ekipi i FSK-së nga Regjimenti i Dytë i Këmbësorisë i Komandës së Forcave Tokësore gjatë garës ka treguar

angazhim të jashtëzakonshëm dhe profesionalizëm të lartë duke arritur Medaljen e Argjendtë. Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdon me sukses në aktivitetet ndërkombëtare. Çmimet për ekipet pjesëmarrëse u ndanë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm

të Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar, gjeneral Roly Walker, ndërsa nga FSK-ja pjesë e kësaj ceremonie ishin atashu i Mbrojtjes, kolonel Agron Bajrami, komandanti i Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë, nënkolonel Jaser Mulla dhe rreshtermajori komandues Fehmi Lulaj.



institucional. “Humbja më e madhe nuk lidhet me pagat e tyre, por me pasojat financiare dhe politike që po shkakton moskonstituimi i Kuvendit”, thekson Jakaj. Sipas tij, mungesa e funksionimit të Kuvendit ka bllokuar miratimin e marrëveshjeve të rëndësishme ndërkombëtare, ndërsa tashmë janë shfaqur probleme serioze edhe në përgatitjen e buxhetit për vitin e ardhshëm. Një nga pasojat më të mëdha, shton ai, është humbja e mundësisë për të përfituar nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, me vlerë rreth 860

milione euro për Kosovën. Jakaj thekson se shtetet e tjera të rajonit tashmë kanë filluar të përfitojnë nga këto fonde të BE-së, ndërsa Kosova po mbetet prapa, pasi nuk ka Kuvend të konstituuar që do ta miratonte marrëveshjen. Të njëjtin shqetësim e ndan edhe Misini, i cili e quan situatën “të papranueshme dhe skandaloze”. “Në këtë gjendje, deputetët nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të tejkaluar bllokadën, duke rrezikuar fondet e BE-së që mund të ndihmonin zhvillimin ekonomik të vendit, i cili tashmë është në

ngadalësim”, thotë Misini. Tendencën e ngadalësimit ekonomik në Kosovë e konfirmojnë edhe të dhënat e Bankës Botërore, sipas të cilave, parashikimet për rritje ekonomike kanë rënë në 3.8 për qind këtë vit, nga 4.4 për qind sa ishin vitin e kaluar. Derisa pritet konstituimi i Kuvendit, tetë muaj pas zgjedhjeve të përgjithshme, Kosova do të mbajë këtë fundjavë edhe zgjedhjet lokale. Për bllokadën e krijuar, politikanët akuzojnë njëri-tjetrin dhe justifikojnë veprimet e veta.

Përfitimet e deputetëve shkojnë përtej pagës bazë

Çështja e pagave të deputetëve rregullohet nga Ligji për pagat në sektorin publik, i cili u garanton atyre jo vetëm pagë bazë, por edhe një sërë përfitimesh shtesë. Deputetët, mes tjerash, marrin shtesa për pjesëmarrje në seanca plenare dhe komisione, të cilat mund të arrijnë deri në 30 për qind të pagës bazë, si dhe kompensime për

udhëtime dhe shpenzime të tjera. Buxheti i shtetit, gjithashtu, mbulon pagat e asistentëve personalë të deputetëve, të cilët konsiderohen staf mbështetës politik. Sipas Rregullores për Shtesa mbi Pagën Bazë për Deputetë dhe për klasifikimin e pagës për stafin mbështetës politik të Kuvendit të Republikës së Kosovës, asistenti i një deputeti ka pagë bazë me koeficient 5.8, plus një shtesë prej 30-përqindësh mbi këtë shumë. Në total, paga mujore e një asistenti arrin rreth 900 euro.

PUNË NGA BEOGRADI PËR SERBËT NË KOSOVË: NDIHMË APO MANIPULIM ZGJEDHOR?

PRISHTINË, 9 TETOR - Serbia paralajmëron 400 vende pune në sektorin shëndetësor në Kosovë gjatë fushatës zgjedhore - lëvizje që kritikët e shohin si ndërhyrje direkte dhe sigurim votash për Listën Serbe, ndërsa të tjerët e perceptojnë si mundësi punësimi. Në komunat me shumicë serbe institucionet shëndetësore funksionojnë brenda sistemit të Serbisë dhe financohen nga buxheti i saj. Akuzat për blerje votash nuk janë të reja, pasi edhe gjatë fushatave të kaluara ka pasur premtime për vende pune, ndihma sociale dhe të tjera.

Paralajmërimet e Serbisë se në ditët e ardhshme do të hapë konkurs për 400 vende të reja pune në institucionet shëndetësore në Kosovë disa i shohin si “ndërhyrje në zgjedhje” ose “sigurim të votave për Listën Serbe” e të tjerë si mundësi punësimi. Paralajmërimet e tilla u bënë në kohën kur në Kosovë po zhvillohet fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Nga Serbia mbështetje gëzon vetëm Lista Serbe, njëherësh partia më e madhe e serbëve në Kosovë.

Mirjana Vasiq nga Graçanica shpreson të punësohet “për të siguruar kushte më të mira për jetesë dhe një të ardhme të sigurt për fëmijët e saj”. Në prill të këtij viti ajo dhe disa qytetarë të tjerë protestuan për më shumë se 20 ditë para institucioneve shëndetësore në Graçanicë, duke kërkuar ndalimin e “punësimeve jotransparente dhe partiake të njerëzve të përshtatshëm”. Konkurs i ngjashëm atëkohë ishte shpallur para zgjedhjeve parlamentare të shkurtit, por më pas ishte anuluar në disa institucione shëndetësore. Vasiq thotë për “Radion Evropa e Lirë” se punën si teknike e farmacisë e kërkon prej 20 vjetësh. “Pas kaq shumë vitesh, shpresoj sinqerisht që shteti ynë, Serbia, të ketë mirëkuptim për një nënë të katër fëmijëve, që jeton me familjen në Kosovë dhe nuk ka ndër mend të largohet”, thotë ajo. Edhe Suzana Bozhiq nga Graçanica shpreson të punësohet në sektorin e shëndetësisë, pasi tash e 18 vjet pret për një vend pune si infermiere dentare. Përndryshe

thotë se do të mendojë të largohet nëse nuk punësohet kur të shpallet konkursi. “Presidenti [i Serbisë] paralajmëroi së voni për hapjen e 400 vendeve të reja pune në sistemin shëndetësor në Kosovë. Unë besoj sinqerisht se do të gjendet një vend edhe për mua, që të punoj në profesionin tim”, thotë Bozhiq për “Radion Evropa e Lirë”. Në mjediset me shumicë serbe në Kosovë të gjitha institucionet shëndetësore funksionojnë brenda sistemit të Serbisë dhe financohen nga buxheti i saj.

Akuza ndaj Serbisë

Disa parti politike serbe në Kosovë e përshkruan hapjen e paralajmëruar të vendeve të reja të punës në sistemin shëndetësor si “blerje votash”. Edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se Serbia po ndërhyr në zgjedhjet lokale në Kosovë, duke ofruar vende pune dhe përfitime financiare. Kurti - qeveria e të cilit ndau të martën ndihmë prej 100 eurosh për studentët, me rastin e fillimit të vitit të ri akademik - i bëri thirrje Bashkimit Evropian që ta dënojë ndërhyrjen e Beogradit në zgjedhjet në Kosovë dhe ta sanksionojë Serbinë për këtë. Në anën tjetër, drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, shkroi në rrjetin social X se Beogradi nuk po ndërhyr në zgjedhje, sepse “Kosova është Serbi”.

Gogiqi: Serbët janë të interesuar për atë që Serbia u ofron

Politologu nga Beogradi, Ognjen Gogiq, thotë se vendet e reja të punës ose ndihma financiare nga Serbia gjatë fushatës zgjedhore në Kosovë, nuk janë diçka e re dhe përbëjnë “armën kryesore” të Listës Serbe. “Problemi këtu është se votuesit ndikohen, dhe kjo nuk është një lojë e barabartë krahasuar me subjektet e tjera politike”, thotë Gogiq për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, serbët në Kosovë nuk janë të interesuar për institucionet kosovare ose punën në to, por i shohin ato “vetëm si mënyrë që të mos u krijojnë probleme në jetën e përditshme”. “Serbët në Kosovë janë të interesuar se çfarë



do t’u ofrojë Serbia në aspektin e vendeve të punës dhe të ndihmës sociale. Ky është faktor kyç që përcakton disponimin e tyre zgjedhor. Kështu, Lista Serbe paraqitet si zëri dhe fytyra e Beogradit, sikurse flet në emër të shtetit të Serbisë”, thotë Gogiq. Ai shton se përfshirja e institucioneve serbe gjatë fushatës zgjedhore në Kosovë, sjell rreziqe për vetë ato, duke kujtuar se gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare, Qendra serbe për Punë Sociale në veri të Kosovës është mbyllur, me arsyetimin se ka ndikuar në vullnetin e votuesve.

Cakolli: Aktivitetet e Serbisë nuk janë vetëm marketing politik

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë për “Radion Evropa e Lirë” se “aktivitetet e paligjshme të institucioneve serbe në Kosovë, kanë implikime të qarta politike gjatë fushatës zgjedhore”. Sipas tij, koha dhe mesazhi që dërgohet ngrenë dyshime se kjo është një përpjekje për “ndikim të koordinuar mbi votuesit”. Megjithatë, ai shton se as institucionet e Kosovës nuk janë “imune” ndaj keqpërdorimit të burimeve gjatë fushatës zgjedhore, dhe se kjo nuk është diçka e re në asnjë vend të rajonit - sidomos në vendet ku “ekzistenca e qytetarëve varet nga ndihmat e institucioneve publike”. Në fakt, janë disa subjekte politike serbe që e kanë akuzuar

Nenad Rashiqin, kreun e Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, për abuzim me pozicionin e tij si ministër i Komuniteteve dhe Kthimit në Qeverinë në detyrë të Kosovës. Gjatë fushatës zgjedhore, Rashiq dorëzoi çelësat e shtëpive të ndërtuara nga Ministria që ai drejton, ose filloi ndërtimin e njësive të reja të banimit. Cakolli thekson se votuesit i perceptojnë veprimet e tilla si një “sinjal besnikërie politike” ose si obligim për ta “kthyer nderin”. “Në praktikë, premtime të tilla shpesh shërbejnë për të njëjtin qëllim, si blerja e votave. Ato e formësojnë sjelljen e votuesve përmes varësisë, jo bindjes”, thotë ai.

Fushatë e re, akuza të njëjta

Konkurset për vende pune në kujdesin shëndetësor dhe ndihmë financiare për të papunët nga buxheti serb, si dhe pajisje shtëpiake dhe subvencione bujqësore nga Qeveria e Kosovës, në këmbim të “votave të sigurta” ishin disa nga akuzat që përshkuan fushatën zgjedhore midis komunitetit serb edhe për zgjedhjet parlamentare të shkurtit. Edhe atëherë disa nga akuzat i referoheshin Listës Serbe, e të tjerat Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë të Rashiqit. Kodi Penal i Kosovës parashikon një dënim prej një deri në pesë vjet burg për çdo person që kërkon ose merr ndonjë avantazh të padrejtë, me qëllim që të votojë për një person të caktuar.

Çfarë saktësisht premtoi Serbia?

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, paralajmëroi më 5 tetor hapjen e konkursit për 400 vende të reja pune në fushën e shëndetësisë në Kosovë. “Kjo është një gjë shumë e rëndësishme për Kosovën dhe Metohinë dhe ne do ta bëjmë këtë në dhjetë ditët e ardhshme, në mënyrë që njerëzit ta dinë... dhe ne gjithmonë do të kujdesemi për ta”, tha Vuçiq për televizionin Pink të Serbisë. Më pas, më 6 tetor, ministri i Shëndetësisë i Serbisë, Zlatibor Lonçar, deklaroi se hapja e 400 vendeve të reja të punës është “një lajm që tregon përkushtimin e Serbisë për mbështetjen e popullit tonë dhe të sistemit shëndetësor në hapësirën e Kosovës dhe Metohisë”. Më 7 tetor, drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, i bëri thirrje komunitetit serb në Kosovë, si dhe personave të shpërngulur që kanë dokumente të Kosovës, të votojnë për Listën Serbe. Ai tha se fitorja e Listës Serbe do të thotë vazhdim i projekteve infrastrukturore dhe ndihmës financiare nga Serbia, duke shtuar se Lista Serbe ka mbështetjen e plotë të presidentit Aleksandar Vuçiq dhe të shtetit serb. Më herët, nga Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë u njoftua gjithashtu se “nga vjeshta, edhe 5 000 serbë në Kosovë do të marrin çdo muaj nga 20 000 dinarë (rreth 180 euro), si ndihmë nga shteti i Serbisë”.

Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor në Gjakovë zbaton planin operativ “Siguria e nxënësve në rrugë”

PRISHTINË, 9 TETOR - Në kuadër të këtij plani operativ, përveç patrullimeve dhe pikave të kontrollit në zonat ku ndodhen shkollat, Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor ka filluar mbajtjen e ligjëratave teorike për sigurinë në trafik dhe aktivitete praktike në komunikacion. Qëllimi i këtyre aktiviteteve

është që nxënësit të njihen më nga afër me rregullat e komunikacionit, rëndësinë e sigurisë rrugore, si dhe me punën e policisë në terren dhe detyrat e saj gjatë menaxhimit të trafikut. Gjatë këtyre aktiviteteve, të shoqëruar nga zyrtarët e Njesisë Rajonale të Trafikut Rrugor, nxënësit morën pjesë në pika

kontrolli dhe panë nga afër demonstrimin e punës policore me qëllim të ngritjes së vetëdijes për sigurinë në trafik. Duke e ditur rëndësinë e sigurisë së nxënësve në trafik, Policia e Kosovës do të vazhdojë me përkushtim të zhvillojë aktivitete të tilla çdo ditë, me qëllim rritjen e vetëdijes dhe sigurisë në komunikacion.



POLICIA E KOSOVËS ARRESTON FATMIR SHEHOLLIN, I DYSHUAR PËR SPIUNAZH

PRISHTINË, 9 TETOR - Autoritetet e Kosovës e kanë arrestuar të enjten një burrë të dyshuar për përfshirje në spiunazh. Prokuroria Speciale e Kosovës tha se i dyshuari u arrestua në rrethin e Prishtinës pas hetimeve disamujore dhe se ai është dërguar në mbajtje për 48 orë.

Ministri i Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, tha se i arrestuari është Fatmir Sheholli, një burrë që ka pasur “hapësira të pakufizuara” në mediet e Kosovës, dhe se ai ka “bashkëpunuar me aktorë që çdo ditë punojnë e vepron për ta minuar Republikën tonë dhe progresin e saj”.

Derisa Prokuroria nuk tregoi se për kë dyshohet të ketë spiunuar ai, Sveçla la të kuptohet se ai mund të ketë spiunuar për Serbinë. “Mbesim të përkushtuar të mbrojmë vendin tonë nga të gjitha qarqet që nuk hezitojnë ta rrezikojnë atë për çfarëdo përfitimi të tyre. Koha e spiunëve të Serbisë në Kosovë ka përfunduar. Kushdo që punon për Serbinë e kundërshtoj Kosovën do të ndiqet pa kompromis e pandalshëm”, shkroi Sveçla në “Facebook”.

Njësitë e Policisë së Kosovës janë duke kryer bastisje në

vendbanimin e të dyshuarit me qëllim të sigurimit edhe të provave të tjera materiale, theksoi Prokuroria në një komunikatë.

Së voni, autoritetet në Kosovë kanë arrestuar, akuzuar e gjykuar serbë e shqiptarë nën dyshimet se po spiunonin për shërbimet e inteligjencës së Serbisë.

Në qershor, gjykata në Prishtinë e dënoi Aleksandar Vllajiqin me pesë vjet burgim, pasi ai u deklarua fajtor për akuzat se ishte përfshirë në spiunazh si anëtar i Agjencisë serbe të Inteligjencës dhe Sigurisë (BIA).

Dy të dyshuar të tjerë, Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi, po gjykohen për spiunazh për Serbinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ata janë deklaruar të pafajshëm për akuzat se kishin dhënë informacione të BIA serbe për disa institucione të sigurisë në Kosovë, për UÇK-në dhe masakrën e Reçakut.

Në një rast tjetër po gjykohet edhe serbja Jellena Gjukanoviqit, e cila akuzohet për spiunazh për inteligjencën serbe. Ajo e ka mohuar fajësinë.

Në Kosovë spiunazhi përkufizohet si aktivitetet sekret i mbledhjes, transmetimit ose



shpërndarjes së informacionit të ndjeshëm në një shtet, organizatë ose grup tjetër. Sipas Kodit Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet me të paktën pesë vjet burgim nëse i dyshuari shpallet fajtor.

Ekspertët kanë thënë se spiunazhi është kërcënim serioz për sigurinë e Kosovës dhe arrestimet e fundit vetëm sa nxjerrin në pah rrezikun e vazhdueshëm. Sipas tyre, ky aktivitet jo vetëm që destabilizon vendin brendapërbrenda, por

dëmton edhe pozitën e tij ndërkombëtare.

Ish-kryeinspektori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), Burim Ramadani, e konsideron spiunazhin një prej kërcënimeve kryesore të sigurisë kombëtare në vend.

HASANI: GJYKATA TREGOI KUSH E BLOKUI KUVENDIN, POR DUHEJ TA SANKSIONONTE SJELLJEN E LV-së

PRISHTINË, 9 TETOR - Instanca më e lartë gjyqësore në vend e konsideron të pakonstituuar Kuvendin dhe për ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimi i fundit është i qartë. “Ajo që gjykata do të duhet të thoshte, megjithatë, ka të bëjë me sanksionimin e sjelljes jokushtetuese të partisë që fiton shumicën e zgjedhjeve nga radhët e shqiptarëve”, ka thënë ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, në një intervistë për “Express”-in. Sidoqoftë, Kushtetuesja, ka thënë ai, “me guxim të madh ka thënë përfundimisht se deputetët kanë detyrim kushtetues për ta zgjedhur nënkryetarin nga radhët e



komunitetit serb, nëse duan të kenë një Kuvend të konstituuar”.

Gjykata ka konstatuar se

procedura për zgjedhjen e Emilija Rexhepit nënkryetare e Kuvendit nga komunitetet e tjera minoritare joserbe nuk

është në kundërshtim me Kushtetutën. “Duke ‘amnistuar’ zgjedhjen e zonjës Emilia Rexhepi, Gjykata Kushtetuese ka ‘shpëtuar fytyrën’ e LV-së, njëkohësisht ka krijuar iluzione tek ata se, me presione terrorizuese, mund të fitojnë koncesione edhe në të ardhmen - koncesione që mund të çojnë në zgjedhjen e një serbi ‘të mirë për pushtetin’, por që nuk e përfaqëson komunitetin serb në Kosovë”, ka thënë Hasani.

Por mënyra e administrimit të shortit, sipas profesorit të së drejtës ndërkombëtare, “ka qenë jokushtetuese” sipas aktgjykimit dhe Hasani ka thënë se Gjykata Kushtetuese

nuk ka konstatuar “asnjë shkelje kushtetuese në veprimet e ‘Listës Serbe’”. “Problemi ka qenë dhe mbetet te sjelljet jokushtetuese, të përsëritura në vazhdimësi, nga partia e parë fituese e zgjedhjeve”, ka thënë ai.

Hasani ka vlerësuar, njësoj siç ka thënë, se ka konstatuar edhe Gjykata, se “gjendja është e qartë dhe e pastër si loti”.

Kushtetuesja “më nuk ka ndër mend të merret me këtë çështje”, ka thënë Hasani, i cili, për dallim prej kolegëve në Kushtetuese, ka thënë se ka frikë se “kjo ‘rashomoniadë’ do të vazhdojë, me aktorë të njëjtë, me të njëjtën qasje dhe me të njëjtin qëllim”.

Osmani në takim me të ngarkuarën e ShBA-së, flasin për funksionalizimin e plotë të institucioneve

PRISHTINË, 9 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të enjten në takim të ngarkuarën me punë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Anu Prattipati. Presidenca ka njoftuar se në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në

vend, për aspekte të ndryshme të bashkëpunimit dypalësh, edhe për pritshmëritë rreth funksionalizimit të plotë të institucioneve pas Aktgjykimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese. Presidentja Osmani dhe

Prattipati diskutuan edhe për takimet dhe bisedat e zhvilluara me presidentin e ShBA-së, Donald J. Trump, dhe me zyrtarë të tjerë të lartë amerikanë gjatë Javës së Nivelit të Lartë të Kombeve të Bashkuara që u mbajt në Nju-Jork.



BQK-ja DHE ODA EKONOMIKE DISKUTOJNË PËR ZGJERIMIN E BASHKËPUNIMIT

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 TETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me bashkëpunëtorët, ka pritur në takim zyrtar kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, me bashkëpunëtorë. Në hyrje të takimit, guvernatori Ismaili e informoi Rafunën lidhur me aktualitetet e sektorit financiar, stabilitetin financiar si dhe treguesit kyçë të sistemit financiar, edhe për angazhimin e BQK-së në krijimin e politikave të qëndrueshme që, krahas rritjes së qëndrueshmërisë së sektorit, kontribuojnë në qasjen në financa, edukimin dhe gjithëpërfshirjen financiare. Më tutje, u diskutua për veprimet e ndërmarra nga BQK-ja në drejtim të avancimit të kornizës ligjore, rregullative

dhe infrastrukturore, duke përfshirë çështjen e procesit të pritshëm të anëtarësimit në SEPA, projektin e pagesave të shpejta (TIPS Clone), projekte të cilat, për shkak të përfitimeve për ekonominë, u mirëpritën dhe mbështetën nga OEK-u. Gjithashtu, u diskutua për kornizën rregullative të sektorit financiar, mundësitë aktuale të qasjes në financa, ndërsa u përmend nevoja e biznesit për avancimin e rregullativës për të mundësuar kanale alternative të financimit përmes tregut të kapitalit, disponueshmërinë e të dhënave të publikuara mbi ekonominë dhe sektorin financiar të cilat mund të shfrytëzohen nga shoqatat e biznesit në aspekt të promovimit të investimeve të huaja. Nismat konkrete lidhur me organizime të përbashkëta u konstatuan si aktivitete me interes të ekonomisë. Nga ana e tij, kryetari i OEK-ut



paraqiti aktivitetet e ndërmarra për promovimin e ekonomisë së Kosovës tek investitorët dhe platformat e ndryshme rajonale dhe vendore, ndërsa falënderoi guvernatorin Ismaili për

përkushtimin në diskutimin rreth qasjes në financa për bizneset si dhe për qëndrueshmërinë e sektorit financiar, si një nga segmentet e rëndësishme të vendit. Takimi është në vazhden e

avancimit të dialogut institucional me organizatat profesionale dhe palët e interesit në fushat me interes të përbashkët publik, derisa u theksua nevoja për një komunikim të vazhdueshëm

AKB-ja: ATK DUHET TË JETË PARTNERE EDUKUESE, JO NDËSHKUESE

PRISHTINË, 9 TETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), me ftesë të drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Mentor Hyseni, mori pjesë në një takim të rëndësishëm me përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizata profesionale të kontabilitetit dhe të auditimit, edhe me përfaqësues të komunitetit të bizneseve. Ky takim kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstucional, me fokus të veçantë në edukimin tatimor dhe zhvillimin profesional si bazë për ndërtimin e një administrate tatimore moderne dhe partneritet të qëndrueshëm me sektorin privat. Gjatë takimit, kryetari i AKB-së, Agim Shahini, theksoi se Administrata Tatimore duhet të ketë rol edukues dhe bashkëpunues me bizneset e



jo të shihet si mekanizëm ndëshkues: “ATK-ja duhet të jetë një institucion edukues dhe partner i komunitetit të

biznesit - jo t'i trajtojë ata vetëm si taksapagues. Ju si udhëheqës i ri që vini nga jashtë ATK-së keni

mundësinë dhe përgjegjësinë të prishni një ‘rrjet merimange’ të krijuar nga brenda sistemit, që ka

dëmtuar bizneset e ndershme ndër vite. 90 % e bizneseve në Kosovë paguajnë tatimet në mënyrë vullnetare - kjo tregon kulturë të lartë fiskale dhe përkushtim ndaj shtetit. Ky kontribut duhet të vlerësohet, jo të paragjykohej”, ka thënë Shahini. Ai ngriti shqetësimin për sjelljen dhe qasjen e disa inspektorëve tatimorë në terren, duke theksuar se këto ankesa janë të përsëritura dhe duhet të adresohen me përkushtim për ta ruajtur besimin mes sektorit privat dhe institucioneve publike. Shahini ka theksuar se Aleanca Kosovare e Bizneseve rritëson përkushtimin e saj për bashkëpunim të hapur dhe konstruktiv me ATK-në dhe institucionet e tjera relevante për të ndërtuar një ambient biznesor më të drejtë, transparent dhe konkurrues në Kosovë.

Më shumë vizitorë në hotele në gusht të këtij viti sesa një vit më parë

PRISHTINË, 9 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelevisë për muajin gusht 2025. Në gusht 2025 numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) në hotele ishte 92 544, prej tyre 35,7 % ishin vendorë dhe 64,3 % ishin të jashtëm. Krahasuar me muajin gusht të


vitet 2024 (sa ishin 76 899 vizitorë), ka pasur rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 20,3 %. Numri i net-qëndrimeve ishte 189 728, prej tyre 39,1 % ishin nga vendorët dhe 60,9 % nga të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm në hotele e ka rajoni i Pejës me 13

914 vizitorë dhe 37 200 net-qëndrimeve. Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (gusht 2024), ka pasur rritje të vizitorëve për 30,7 %. Në total, ishin 59 485 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishin nga: Gjermania, Shqipëria, Zvicra, Turqia etj.



ÇFARË JANË RAKETAT TOMAHAWK QË UKRAINA KËRKON NGA SHBA? MBI 2 000 BAZA RUSE NË RREZIK

Le caratteristiche



Nëse Donald Trump jep dritën për fundimtare, kjo nuk do të ishte një dhuratë e mirë ditëlindjeje për Putinin. Kiev s'është shpejt mund të sigurojë leje për të blerë dhe përdorur raketa Tomahawk.

Më të fuqishëm se Atacm, të aftë të fluturojnë midis 700 dhe 1500 miljeve (Atacm kanë një rreze veprimi prej 190 miljesh) dhe të prodhuar në SHBA, të projektuar për të goditur objektiva tokësore nga deti dhe nga platformat nënujore, Tomahawk-ët janë raketa lundrimi me fluturim të ulët, një karakteristikë që i bën ato të vështira për t'u zbuluar.

Të përdorura në betejë të ndryshme, që nga "Stuhia e Shkretëtirës" në Irak deri në Siri kundër ISIS-it dhe në Karaibe kundër trafikantëve të narkotikëve, ato janë një armë që Shtetet e Bashkuara nuk do t'u mbaronte edhe nëse do të vendosnin t'ia jepnin disa prej tyre aleatit të tyre ukrainas. Nuk ka rrezik që Shtëpia e Bardhë të minojë politikën "Amerika e Para" në lidhje me rezervat ushtarake, siç ndodhi me raketat "Patriot".

Sipas një analize nga Instituti për Studimin e Luftës, Tomahawk-ët do t'u lejonin ukrainasve të ulnin ndjeshëm efektivitetin luftarak të ushtrisë ruse në vijat e frontit. Sipas analistëve, forcat e Kievit janë tashmë të afta të kryejnë sulme me dronë me rreze të gjatë veprimi mbi pjesën më të madhe të territorit armik, por

ngarkesat e tyre mbeten të kufizuara dhe të papërshtatshme për shkatërrimin e objektivave strategjikë.

Ndërsa Tomahawk-ët mund të shkaktojnë më shumë dëme sesa dronët. Vlerësohet se të paktën 1 945 objektiva ushtarake ruse janë brenda rrezes prej 2 500 kilometrash të variantit, ndërsa versioni prej 1 600 kilometrash mund të arrijë të paktën 1 655 objektiva.

Këto – raporton më tej ISW – përfshijnë fabrikën Shahed në Yelabuga, në Republikën e Tatarstanit, dhe bazën ajrore

Engels-2 në Saratov Oblast, nga e cila Rusia kryen sulme me bombardues strategjikë që lëshojnë raketa lundrimi kundër Ukrainës.

Fushata DeepStrike (siç e quajnë ukrainasit), deri më tani e bazuar në përdorimin e dronëve, po pengon drejtpërdrejt operacionet dhe linjat e furnizimit rus. Në më pak se dy muaj, forcat e Kievit thuhet se kanë goditur 85 objektiva me vlerë të lartë në tokën ruse.

Këto përfshijnë 33 vende ushtarake, baza, depo, aeroporte dhe avionë tokësorë,

si dhe 52 objekte ushtarako-industriale që prodhojnë armë, municione, karburant dhe dronë. Me fjalë të tjera, nëse përforcohet me raketa me rreze të gjatë veprimi, DeepStrike mund të shkaktojë dhimbje koke të mëtejshme për Kremlinin.

Teksa pret që Trump të heqë rezervën, Kiev ka filluar tashmë prodhimin në seri të raketës së saj të re "FP-5 Flamingo" të zhvilluar në mënyrë vendase, me një rreze veprimi prej 3 000 kilometrash dhe një kokë rakete prej 1 150 kilogramësh. Megjithatë,

testimi nuk ka përfunduar ende dhe Ukrainës i duhet ende kohë për të rritur prodhimin. Megjithatë, sipas "The Economist", nëse Flamingo do të depërtonte në mbrojtjen ajrore ruse, kjo do ta çonte fushatën DeepStrike të Ukrainës në një nivel të ri të fuqisë shkatërruese.

Rrezja e veprimit të raketës i lejon asaj të shmangë mbrojtjet duke ndryshuar vazhdimisht rrugët e fluturimit gjatë rrugës drejt objektivit. Dhe jo vetëm kaq. Emri – dhe ngjyra rozë – u zgjodhën nga Iryna Terekh, CEO dhe drejtoreshë teknike e kompanisë që i prodhon ato – një veçori që i jep fund përfundimisht monopolit mashkullor në prodhimin e kokave bërthamore. Një pengesë e mëtejshme për "Carin".

"Flamingo" ka edhe avantazhe të tjera ndaj "Sioux Hatchet". Sipas "The Economist", prodhimi i Flamingo-s përfshin motorë turbofan të rinovuar të epokës sovjetike, me trupa prej fibrash karboni që kërkojnë vetëm 6 orë prodhim.

Aktualisht, po ndërtohen dy versione, me dy deri në tre raketa FPV-5 në ditë, një shifër që pritet të rritet në 7 deri në fund të muajit. Secila kushton rreth 500 000 dollarë. Shumë më pak se një Tomahawk, i cili kushton 4 herë më shumë dhe është më i vështirë për t'u kapur. Flamingo ka vetëm një të metë: është më pak i saktë.



KUSH JANË FAVORITËT PËR NOBEL-n E PAQES DHE A NDODHET TRUMP MES TYRE?



Pak para shpalljes së çmimit, një gjë është e sigurt: Donald Trump nuk do ta marrë Çmimin Nobel për Paqen që dëshiron kaq shumë këtë vit. Por kë do të tërheqë Komiteti Norvegjez i Nobel-it nga kapelja e tij? Çmimi Nobel për Paqen do të shpallet të premten në orën 12:00 GMT në Oslo, në një kontekst mjaft të errët: që nga fillimi i regjistrimeve në vitin 1946, numri i konflikteve të armatosura nuk ka qenë kurrë aq i lartë sa në vitin 2024, sipas Universitetit Uppsala të Suedisë. Një gjë duket e sigurt. Edhe pse ai pretendon se e meriton çmimin për rolin e tij në zgjidhjen e tetë konflikteve, Donald Trump nuk do ta fitojë atë, të paktën jo këtë herë, nëse u besohen vëzhguesve. “Jo, nuk do të jetë Trump këtë vit”, tha për AFP profesori suedez Peter Wallensteen, një ekspert për çështjet ndërkombëtare. “Ndoshta vitin tjetër? Deri atëherë, pluhuri do të jetë ulur

mbi iniciativat e tij të ndryshme, veçanërisht në krizën e Gazës”, shtoi ai. Ekspertët e konsiderojnë reputacionin e presidentit amerikan si “paqebërës” shumë të ekzagjeruar dhe shprehin shqetësime në lidhje me ndikimin e linjës së tij “Amerika e Para”. “Përtej përpjekjeve të tij për të ndërmjetësuar në Gaza, po shohim politika që bien ndesh me qëllimet dhe parimet e vullnetit të Nobel-it”, përkatësisht bashkëpunimin ndërkombëtar, vëllazërinë midis popujve dhe çarmatimin, thotë Nina Greger, drejtreshë e Institutit të Kërkimeve për Paqen të Oslos (PRIO). Tërheqja nga organizatat ndërkombëtare dhe traktatet shumëpalëshe, një luftë tregtare “madje edhe kundër miqve dhe aleatëve të vjetër”, pikëpamjet anti-Danimarkë, përdorimi i ushtrisë në qytetet amerikane,



sulmet ndaj lirisë akademike dhe lirisë së shprehjes...: lista e ankesave është e gjatë. “Ne e shohim të gjithë pamjen”, shpjegon Jürgen Vande Fridnes, kryetari i komitetit prej pesë anëtarësh që jep Çmimin Nobel për Paqen. “Ajo që ka rëndësi është organizata ose personaliteti në tërësi. Por ajo që ne shikojmë para së gjithash është ajo që ata kanë arritur konkretisht në shërbim të paqes”, thotë ai.

Një laureat i Nobel-it “jo shumë i diskutueshëm”?

Këtë vit, 338 individë dhe organizata janë nominuar për Çmimin Nobel, një listë që ka mbetur sekret për 50 vjet. Dhjetëra mijëra njerëz (parlamentarë dhe ministra nga të gjitha vendet, ish-laureatë, disa profesorë universiteti, anëtarë të Komitetit të Nobel-it, etj.) mund

të paraqesin një emër si kandidat. Në vitin 2024, Çmimi Nobel iu dha Nihon Hidankyo, një organizatë e të mbijetuarve të bombardimeve të Hiroshimës dhe Nagasakit që po zhvillon një “kryqëzatë” kundër armëve bërthamore. Në mungesë të një favoriti të qartë, emra të ndryshëm qarkullojnë në Oslo: rrjeti vullnetar sudanez i Ekipit të Reagimit të Menjëhershëm (ERR), rusja Yulia Navalny, e veja e figurës së opozitës Alexei Navalny, ose misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) (OBIDDH). Vitet e fundit, në përzgjedhjet e komitetit të Nobel-it, “kemi parë një kthim në gjëra pak më afër ideve klasike të paqes, duke ruajtur lidhjen me të drejtat e njeriut, demokracinë, lirinë e shtypit dhe gratë”, thotë Halvard Leyra, drejtor kërkimesh në Institutin Norvegjez të Çështjeve

Ndërkombëtare (NUPI). “Intuita ime është se këtë vit një person që nuk është shumë i diskutueshëm do të zgjidhet për çmimin”, thotë ai. Komiteti i Paqes i Nobel-it mund të zgjedhë kështu të theksojë edhe një herë angazhimin e tij ndaj një rendi botëror të sfiduar nga Donald Trump duke ia dhënë çmimin shefit të OKB-së António Guterres dhe/ose një agjencie të OKB-së si UNHCR ose agjencia palestineze e refugjatëve (UNRWA). Ai gjithashtu mund të nxjerrë në pah drejtësinë ndërkombëtare – Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë të OKB-së (GJND) ose Gjykatën Ndërkombëtare Penale – ose lirinë e shtypit, e cila është nën kërcënim, duke i dhënë çmime organizatave joqeveritare si Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve (CPJ) dhe Reporterët pa Kufij (RSF). Ose mund të zgjedhë surprizën, siç bën shpesh.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova synon fitore ndaj Sllovenisë

PRISHTINË, 9 TETOR - Kombëtarja e Kosovës ka zhvilluar stërvitjen e fundit në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen ndaj Sllovenisë e cila do të zhvillohet në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës 2026. Kjo ndeshje do të

zhvillohet sonte (e premte) në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë me fillim nga ora 20:45. Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, ka shprehur optimizëm se Kosova do ta mposhtë

Slloveninë. Edhe atmosfera në kampin e "Dardanëve" është e shkëlqyer. Futbollistët kanë treguar përkushtim të lartë dhe dëshirë maksimale për të arritur fitore në ndeshjen kundër Sllovenisë. Pas Sllovenisë, Kosova do të

luajë në Goteborg kundër Suedisë. Një fitore në Prishtinë do t'i rriste ndjeshëm gjasat e "dardanëve" për të siguruar së paku "play-off"-in drejt Kupës së Botës "ShBA, Meksikë & Kanada 2026".



PRESIDENTI I FSHF-së BESON NË FITORE NDAJ SERBISË



TIRANË, 9 TETOR - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), Armand Duka, ka besim se Shqipëria mund t'i fitojë pikët e plota kundër Serbisë në Lekovc. Në një intervistë në kanalin "FSHF TV", Duka ka theksuar se pret nga lojtarët të jenë të qetë dhe të përqendruar vetëm në fushën e lojës.

Deklaratat e Dukës janë publikuar të mërkurën në sajtin e FSHF-së. "Ndeshje shumë e rëndësishme në këndvështrimin sportiv. Nuk mund ta lëmë mënjatë që ka edhe ngarkesë në atmosferë. Dje ne kemi pasur një

takim me ekipin dhe ajo që i kemi kërkuar ekipit, dhe kemi besim tek ekipi, është të ketë një përqendrim dhe qetësi sportive. Është shumë e rëndësishme sepse të dyja skuadrat presin tri pikë nga kjo ndeshje për ta vazhduar rrugëtimin për plejof. Ta vazhdojë udhëtimin ajo skuadër që të jetë më e qetë, që di ta vlerësojë sportivisht ngjarjen dhe mos ta ngatërrojë me ngarkesa të tjera që janë të pashmangshme. Unë uroj që Serbia ta ketë këtë ngarkesë më shumë se ne. Kam shumë besim tek ekipi ynë", ka thënë Duka.

Duka ka theksuar se Serbia si ekip nuk është cilësore. Sipas tij, Serbia ka vetëm disa futbollistë cilësorë. "Ne kemi një ekip të mirë dhe që di të përballet me çdo lloj kundërshtari. Kam shumë besim që mund të bëjmë një rezultat pozitiv në Serbi, duke pasur parasysh vështirësinë e madhe dhe cilësinë që kanë kryesisht futbollistët serbë, jo skuadra serbe", është shprehur Duka. Ndeshja Serbi - Shqipëri luhet të shtunën nga ora 20:45 në Lekovc. Kjo ndeshje u takon kualifikimeve për Kupën e Botës 2026.

NDESHJA E LA LIGAS MES BARCELONËS DHE VILLARREALI DO TË ZHVILLOHET NË SHBA

MIAMI, 9 TETOR - Ndeshja e La Ligës ndërmjet Barcelonës dhe Villarrealit do të zhvillohet në "Hard Rock Stadium" në Miami të ShBA-së. La Liga ka tentuar prej disa vitesh të organizojë një ndeshje në ShBA, por në vitet 2023 dhe 2024 nuk ka marrë miratimin e nevojshëm për ta bërë këtë të mundur. Situata ndryshon në vitin 2025. Fillimisht këtë javë UEFA ka dhënë miratimin me rezerva për zhvillimin e ndeshjes, që do të thoshte se mungonte vetëm pëlqimi i FIFA-s. Edhe pse ky miratim ende nuk ka ardhur zyrtarisht, presidenti i La Liga, Javier Tebas, ka konfirmuar se ndeshja ndërmjet Villarrealit dhe



Barcelonës do të luhet në Miami. "Përveç një çështjeje të vogël formale, procesi tashmë ka përfunduar. Mund të themi se të shtunën, më 20 dhjetor, një ndeshje zyrtare e La Ligës, Villarreal-Barcelona, do të luhet në Miami, një ndeshje me pikë në lojë. Në vend se të zhvillohet në 'Estadio de la

Cerámica' në Villarreal, ajo do të luhet në 'Hard Rock Stadium', është thënë në njoftim. Tebas, gjithashtu, ka zbuluar se La Liga do të shkojë në Shtetet e Bashkuara disa javë para ndeshjes Villarreal - Barcelona për ta promovuar ligën dhe ndeshjen. "Ne do të shkojmë katër ose pesë javë para ngjarjes sportive dhe do t'i bëjmë publike aktivitetet që organizon La Liga, nga liga jonë për personat me aftësi të kufizuara, te klubet me ambasadorët e tyre. Do të vizitojmë qytete të ndryshme në Shtetet e Bashkuara për t'u bërë më shumë të njohur", ka thënë Tebas.

HENDBOLL: RAHOVECI E KËRKON NË LUKSEMBURG SUKSESIN EVROPIAN

RAHOVEC, 9 TETOR - Kampioni i Kosovës, Rahoveci, do të luajë në Luksemburg në kuadër të raundit të dytë të Kupës Evropiane për hendbollistë. Rahoveci përballet me skuadrën nga Luksemburgu, Dudelange. Ndeshja e parë zhvillohet sonte (e premte) në orën 20:00, ndërsa e dyta pasnesër (e shtunë) në orën 20:30. Të dyja ndeshjet do të zhvillohen në Dudelange. "Vreshtarët" janë pajtuar që dy ndeshjet t'i luajnë në udhëtim, pasi palestra e tyre është e zënë për shkak të zgjedhjeve lokale. Por, Rahoveci e kërkon suksesin evropian të radhës. Kjo skuadër



ka debutuar në gara evropiane në edicionin 2022/2023. Vjet në raundin e dytë të Kupës Evropiane e ka eliminuar Bocholtin belg. Në raundin e tretë ishte ndalur nga skuadra rumune Minaur Baia Mare.

Gerrard nuk e përjashton mundësinë e rikthimit te Rangersi

GLASGOW, 9 TETOR - Legjenda e Liverpoolit, Steven Gerrard, e ka lënë të hapur mundësinë për t'u rikthyer në stolin e Rangersit, pas shkarkimit të trajnerit Russell Martin nga drejtuesit e klubit skocez. Në një intervistë për podkastin "Rio Ferdinand

Presents", Gerrard ka pranuar se deri më tani nuk ka qenë i gatshëm për t'u rikthyer në trajnim, por nuk e përjashton këtë mundësi në të ardhmen e afërt.

"Nuk kam qenë gati, sepse nuk e kam pasur ekipin tim të plotë të

trajnerëve. Edhe koha nuk ka qenë e duhur. Vajza ime sapo ka pasur një foshnjë dhe unë sapo jam bërë gjysh. Nuk kemi qenë gati as unë e as stafi im", ka thënë Gerrardi.

Megjithatë, ai ka theksuar se është i hapur për sfidën e radhës nëse

vjen oferta e duhur. "Nëse vjen thirrja e duhur, nga klubi i duhur dhe në momentin e duhur, do ta marr atë sfidë, sepse është pjesë e imja", ka thënë Gerrardi. Ish-trajneri i Rangersit e kishte udhëhequr skuadrën drejt titullit kampion të Skocisë.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Mbikëqyrës/e i/e Sistemeve të TI-së dhe Rrezikut Kibernetik
Grada e pozitës: P06
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti/ Divizioni: Divizioni i Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësi:

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është në kërkim të një kandidati të kualifikuar dhe të motivuar për pozicionin e Mbikëqyrësit të Sistemeve të TI-së dhe Rrezikut Kibernetik në Divizionin e Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së. Ky rol është thelbësor për të siguruar që institucionet financiare nën autoritetin tonë rregullator të mbajnë sisteme informacioni dhe korniza sigurie kibernetike të qëndrueshme, të sigurta dhe në përputhje me kërkesat rregullative. Kandidati i suksesshëm do të jetë pjesë e një ekipe përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rreziqeve të TI-së dhe atyre kibernetike në sektorin financiar, duke siguruar që institucionet përmbushin kërkesat rregullative dhe praktikrat më të mira.

Përgjegjësitë Kryesore

- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i sistemeve të informacionit dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut kibernetik brenda institucioneve financiare për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat rregullative.
- Kryerja e vlerësimeve të rrezikut të TI-së dhe atyre kibernetike, identifikimi i dobësive, kërcënimeve dhe ndikimeve të mundshme në stabilitetin financiar të institucioneve.
- Sigurimi që institucionet e mbikëqyrura të jenë në përputhje me kërkesat rregullative të aplikueshme në vend të sigurisë kibernetike dhe TI-së.
- Monitorimi dhe vlerësimi i përgjigjes së institucioneve ndaj incidenteve kibernetike, duke ofruar udhëzime dhe rekomandime për të zvogëluar rreziqet dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre.
- Bashkëpunimi me palët e interesit të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë institucionet financiare, ekspertët e industrisë dhe agjencitë qeveritare, për të promovuar qëndrueshmërinë kibernetike në të gjithë sektorin.
- Përgatitja dhe prezantimi i raporteve mbi vlerësimet e rrezikut të TI-së dhe atij kibernetik për menaxhmentin e lartë, duke theksuar gjetjet kryesore, rekomandimet dhe fushat me shqetësime.

Përgatitjet profesionale/kualifikimet:

- Diplomë universitare në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit, Siguri Kibernetike, Shkenca Kompjuterike ose të ngjashme qe ndërlidhen me Sisteme te Informacionit.
- Të paktën 2 vite përvojë në mbikëqyrjen e TI-së, auditim të TI-së, sigurinë kibernetike ose role të ngjashme, preferohet në industrinë e shërbimeve financiare ose në një autoritet rregullator.
- Certifikimet përkatëse si CISSP, CISM ose CISA janë shumë të dëshirueshme.
- Njohuri mbi sistemet e informacionit, qeverisjen e sistemeve të informacionit, kornizat e sigurisë kibernetike, praktikrat e menaxhimit të rrezikut dhe përputhshmërinë me rregullativën në sektorin financiar.
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe zgjidhje problemesh, me aftësinë për të vlerësuar çështjet komplekse të sistemeve të informacionit dhe atyre kibernetike dhe për të zhvilluar zgjidhje praktike.
- Njohuri të rregulloreve, standardeve dhe udhëzimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e TI-së dhe sigurinë kibernetike.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formulari zyrtar i BQK-së për aplikim, i cili plotësohet gjatë aplikimit online;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **27 tetor 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: Supervizor IT sistema i sajber rizika
Rang pozicije: P06
Trajanje zaposlenja: Na neodređeno vreme
Odeljenje/Odsek: Odsek za nadzor IT sistema
Izveštava: Rukovodioc Odseka za nadzor IT sistema

Rezime dužnosti i odgovornosti:

Centralna banka Republike Kosovo traži kvalifikovanog i motivisanog kandidata za poziciju Supervizora IT sistema i sajber rizika u Odseku za nadzor IT sistema. Ova uloga je neophodna kako bi se osiguralo da finansijske institucije pod našim regulatornim ovlašćenjem održavaju informacione sisteme i okvire za sajber bezbednost koji su robusni, bezbedni i u skladu sa regulatornim zahtevima. Uspešan kandidat će biti deo tima odgovornog za nadgledanje i procenu IT i sajber rizika u finansijskom sektoru, osiguravajući da institucije ispunjavaju regulatorne zahteve i najbolje prakse.

Glavne odgovornosti:

- Nadgledanje i procena informacionih sistema i praksi upravljanja sajber rizicima unutar finansijskih institucija kako bi se osigurala usklađenost sa regulatornim zahtevima.
- Sprovođenje procena IT i sajber rizika, identifikovanje slabosti, pretnji i potencijalnih uticaja na finansijsku stabilnost institucija.
- Osiguravanje da nadgledane institucije budu u skladu sa važećim regulatornim zahtevima u zemlji u oblasti sajber bezbednosti i IT-a.
- Praćenje i procena odgovora institucija na sajber incidente, pružanje smernica i preporuka za smanjenje rizika i sprečavanje njihovog ponavljanja.
- Saradnja sa internim i eksternim zainteresovanim stranama, uključujući finansijske institucije, stručnjake iz industrije i vladine agencije, kako bi se promovisala sajber održivost u celokupnom sektoru.
- Pripremanje i predstavljanje izveštaja o procenama IT i sajber rizika višem rukovodstvu, naglašavajući ključne nalaze, preporuke i oblasti gde ima zabrinutosti.

Stručna sprema/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti informacionih tehnologija, sajber bezbednosti, računarskih nauka ili sličnog smera vezanog za informacione sisteme.
- Najmanje 2 godine iskustva u IT nadzoru, IT reviziji, sajber bezbednosti ili sličnim ulogama, poželjno u industriji finansijskih usluga ili regulatornom telu.
- Veoma su poželjni relevantni sertifikati kao što su CISSP, CISM ili CISA .
- Poznavanje informacionih sistema, upravljanja informacionim sistemima, okvira za sajber bezbednost, praksi upravljanja rizicima i usklađenosti sa propisima u finansijskom sektoru.
- Odlične analitičke sposobnosti i sposobnosti rešavanja problema, sa sposobnošću procene složenih informacionih sistema i sajber problema i razvoja praktičnih rešenja.
- Poznavanje nacionalnih i međunarodnih propisa, standarda i smernica vezanih za oblast IT-a i sajber bezbednosti.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu, koji se popunjava tokom onlajn prijave;
- Motivaciono (propratno) pismo u kojem se navodi interesovanje i podobnosti za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje zauzete pozicije i radnog iskustva, bez ugrožavanja na relevantne zakone o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PAK) kada izveštaj Trusta nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, pri čemu diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi kao dokaz o državljanstvu Kosova.

Postupak apliciranja:

- Zadnji rok za aplikaciju je **27 oktobar 2025. godine**.
- Prijava se može podneti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Drugi oblici aplikacije neće biti uzeti u obzir.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Global Call Center” L.L.C. Gjilan me pronar Arbër Zeneli ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812289991 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE


Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Global Call Center” L.L.C. Gjiilan, Arbër Zeneli donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812289991 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Global Call Center” L.L.C. Gjilan, Arbër Zeneli, has come to the decision to quit its business: 812289991 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Argjend Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Furrës së bukës.
- “Kalaja”, Sh.P.K me numër Unik identifikues: 810246159 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër: 330008921.
- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.
- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.
- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.
- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.
- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.
- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.
- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.
- “Fire Protection Agency Rifel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.
- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.
- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L